

AKTI I THEMELIMIT

TE SHOQERISSE "SINANI" shpk



E perpiluar sot me date 20.4.1995 nga ortaku i vetem Gani Sinani, i biri i Beshirit, dtl.1942, lindur e banues ne Gramsh, lagjja Pishaj. Duke u bazuar ne ligj dhe ne kete akt vendosa qe te krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 1

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

- Ne fushen e tregtise se karburanteve e vajrave lubrifikan me pike shitje me distributorore me pakice, ne fushen e tregtimit te llrave te ndryshme mshqimore dhe industriale, importi dhe eksporti me shumice e pakice, ne fushen e transportit te mallrave si brenda dhe jashte.

Neni 2

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleften 100.000 le i cili eshte i vene nga ortaku i vetem.

Neni 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te quhet "SINANI". Ajo do te fitoje personalitetin e saj juridik nga dita e regjistrimit te saj ne librin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 4

Shoqeria do te kete qendren e saj ne qytetin e Gramshit ne lagjen Pishaj. Ajo ka te drejte te hape dhe agjenci apo dega tjera ne rretha te tjera.

Neni 5

Shoqeria do te kete nje aktivitet prej me shume se 10 vje.

Neni 6

Administrator do te jete z. Gani Sinani.

Neni 7

Fitimi u realizua nga veprimtaria e shoqerise siq u f me siper, merret nga ortaku i vetem, mbasi dhe kontributin e kapitalin themeltar eshte i tij.

Neni 8

Ortaku i vetem ka te drejte te marre vendime per veprimtari e shoqerise.

Neni 9

Ortaku mund te terhiqet nga shoqeria, mbasi te kete shlyer te gjitha detyrimet financiare qe rrjedhin nga veprimtaria e kesaj shoqerie.

Neni 10


Ortaku ka per detyre te zbatoje me rigorozitet ligjet per ushtrimin e veprimtarise private si dhe kushtet e ketij akti themelimi.

Neni 11

Ortaku i vetem bie dakord qe te gjitha mosmarreveshjet qe do te mund te lindin midis tij dhe personave te tjere fizik dhe juridik apo tetretet qe do te zgjidhe me mirekuptim ose ne te kundert do t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Tirane.

ORTAKU I VETEM

GANI SINANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA E NOTERISE TIRANË

Nr. 919 Rep

Nr. 454 Kol

V E R T E T I M

Sot më datën 21.4.1995, para meje noteres u paraqit personalisht Gani Sinani për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi, madhe me sotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i cili deklaroi se sasiptë e ka nënshkruar me vullnetin e tij të lirë e të shprehur dhe unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.



NOTE
MIRANDA XHEMALCE
NOTERE
TEL 262 84
TIRANE



STATUTI

I SHOQERISE "SINANI" sh.p.k.

1. HYRJE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "SINANI" krijohet mbi bazen e iniciatives se lire dhe te kapitalit themeltar e personal te ortakut te vetem / Gani Sinani, i biri i Beshirit, dtl.1942, lindur e banues ne Gramsh, ne lagjen Pishaj,.

Shoqeria krijohet dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me te gjitha normat e ketij statuti dhe te legjislacionit ne fuqite te Republikes se Shqiperise si dhe me ligjin nr.7632, date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar" dhe ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare!"

Kjo shoqeri si shpk i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

2. OBJEKTI

Tregtimi i karburanteve dhe vajrave lubrifikante me pike shitje si distributor , shitje me pakice, ne fushen e tregtimit te mallrave te ndryshme ushqimore e industriale, importi dhe eksporti me shumice e pakice, ne fushen e transportit te mallrave si brenda* ashtu dhe jashte vendit.

3. EMERTIMI, SELIA, TERRITORI

Kjo shoqeri do te emertohet "SINANI" shpk

Ajo do te krijoje personalitetin e saj juridik privat nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Shoqeria do te kete qendren e saj te pare ne qytetin e Wizar ne rrug Gramshit, ne lagjen Pishaj.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Ajo mund te krijoje dega apo agjenci dhe ne rrethe te tjera te Shqiperise.

4. KAPITALI THEMELOR I SHOQERISE

Kapitali themelor i shoqerise perbehet nga kontributi i ortakut te vetem me vleften 100.000 leke.

Kapitali eshte i depozituar dhe i likujdueshem nga ortakut i vetem. Kapitali themeltar eshte i depozituar ne njeren prej bankave te qytetit te Gramshit para fillimit te veprimtarise se shoqerise.

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet ne varesi te rezultateve dhe nevojave ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshme ne rrugate trashegimie.

5. FONDET E SHOQERISE

Shoqeria percakton fondet e meposhtme :

- Fondin themelor (qarkullues)
- Fondin rezerve
- Fonde te tjera te cilat mund te jene te nevojshme gjate

veprimtarise se saj.

Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te tij percaktohet me vendim te organit drejtues te shoqerise.

6. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- Shoqeria do te derejtohet nga ortakut i vetem, administratori z. Gani Sinani.

Raport i administrimit, inventarit dhe llogarite vjetore do te hartohen nga administratori. Ortaku i vetem mund te delegoje komitetat e tij, vendimet e tij te marra ne vend te asamblese, evidentohen ne nje regjister.

Ortaku i vetem miraton llogarite, nese eshte e nevojshme para raportit te eksperteve kontabel te autorizuar prej tij, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

7. KOMPETANCAT E ORTAKUT TE VETEM

Vendos per ndryshimet ne statut dhe miraton rregullonen e shoqerise.

Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se shoqerise.

Zgjedh dhe shkarkon drejtorin ekzekutiv të shoqërisë.

Shqyrton bilancin vjetor, kuotat, fondet e ndryshme si dhe fitimin e realizuar. Vendos për krijimin e degëve e agjencive të shoqërisë brenda dhe jashtë vendit.

Vendos për marrjen e kredive si dhe për mbarimin e shoqërisë. Vendos për pagat e punonjësve të punësuar në këtë shoqëri. Emeron një ose disa eksperte kontabel për të ushtruar kontrollin mbi aktivitetin ekonomik financiar të shoqërisë.

8. NDARJA E FITIMIT

Pas përballimit të detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve të ndryshme ortakut të vetëm i mbetet në dispozicion fitimi neto.

Fitimi neto mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit, për shtimin e kapitalit themeltar, në kapital në natyrë.

9. KONEZGJATJA E SHOQËRISDE

Shoqëria krijohet për një afat përmbi 10 vjet.

10. MBARIMI I SHOQËRISDE

Veprimtaria e shoqërisë mbaron në vendimin e ortakut drejtues në rast se veprimtaria e saj nuk rezulton fitim prurës, për shkak të forcës mëdhe si dhe për shkaqe të tjera ligjore. Shoqëria mund të mbarojë me anë të thithjes së saj ose bashkimit.

11. MARRËDHENIET E PUNESIMIT

Cdo person i punësuar në shoqëri konsiderohet si i punësuar mbi bazën e kontratës së punës së lidhur ndërmjet tij dhe shoqërisë përputhje me legjislacionin e punës në Shqipëri.

12. DISPOZITA TË FUNDIT

Fiti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe të çdo viti dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet në institutin e sigurimeve shoqërore të Republikës së Shqipërisë.

O R T A K U

GANI SIMANI

Simani